



**BASHKIA
TIRANË**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 162, datë 18.12.2020

**PËR
DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR 14 (KATËRMBËDHJETË) FAMILJE
QË KANË PËSUAR DËME NDËRTIMORE DHE NË ORENDI/ PAJISJE
ELEKTROSHTËPIAKE SI PASOJË E ZJARRIT DHE PËRMBYTJES**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Kreut III, pika 1, shkronja “ë”, të vendimit nr. 329, datë 16.05.2012, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, vendimit nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të akordojë ndihmën financiare prej 3,088, 169.50 (tre milionë e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë) lekë për 14 (katërmëdhjetë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake, si pasojë e zjarrit dhe përmytjes, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
 2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i pikës 1, të këtij vendimi, të përballohen nga fondi i emergjencave i parashikuar në Programin e Mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtja civile (Kod Programi 03280) të Aparatit të Bashkisë në artikullin 606 në buxhetin e vitit 2020 të Bashkisë së Tiranës.
 3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO